



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE  
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL  
SEKTORI I PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT

**ZNJ. N. GJ.**

Në përgjigje të shkresës suaj protokolluar me tonën nr. 394 prot., datë 20.01.2025, përmes së cilës kërkon anulimin e procedurës mbi thirrjen për shprehjen e interesit për të sapodiplomuarit studentë të ekselencës për institucionet e administratës shtetërore, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Në zbatim të vendimit nr. 586, datë 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike, më datë 26.11.2024, ka publikuar “Thirrjen për shprehjen e interesit për të sapodiplomuarit studentë të ekselencës për institucionet e administratës shtetërore”. Afati i aplikimit dhe i ngarkimit të dokumentacionit për këtë thirrje ka qenë data 12.12.2024.

Në kuadër të thirrjeve të tilla, studentëve të ekselencës i ofrohet mundësia e punësimit me kontratë të përkohshme 1-vjeçare, në pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive (specialist dhe të barasvlefshëm) në institucionet e administratës shtetërore. Qëllimi i kësaj iniciative është krijimi i kushteve të nevojshme për studentët e ekselencës, për të përfituar eksperiencë të përshtatshme pune, për zhvillimin e karrierës së tyre të mëvonshme në administratën publike shqiptare.

Procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të përkohshëm të studentëve ekselentë realizohet nëpërmjet një procedure konkurrese, e cila zhvillohet në dy faza:

- a) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përcaktuara në VKM-në nr. 586/2019, të ndryshuar;
- b) Vlerësimi i kandidatëve, ku përfshihet vlerësimi:
  - i. mbi bazën e mesatares së ponderuar;
  - ii. mbi bazën e nivelit të diplomës, vendit ku është kryer studimi dhe institucionit të arsimit të lartë;
  - iii. i angazhimeve të kandidatëve në aktivitete ekstrakurrikulare, vullnetarizmi dhe skema mobiliteti.

Në fazën e verifikimit paraprak, Departamenti i Administratës Publike, me qëllim gjykimin mbi kualifikimin ose jo të kandidatëve, merr në shqyrtim dokumentacionin e kandidatëve të ngarkuar në portal dhe verifikon kriteret të cilat lidhen me:

- Vitin e diplomimit (sipas VKM-së nr. 586/2019, të ndryshuar dhe shpalljes të diplomuarit duke filluar nga viti 2021 e në vijim);
- Mesataren e ponderuar, duke marrë në konsideratë: (i) mesataren e shënuar në listën e notave apo (ii) mesataren e ponderuar të përlogaritur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në rastet kur ajo nuk ishte e shënuar në listën e notave apo për kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë Shqipërisë (sipas vendimit mesatarja 9.00 – 10.00);
- Faktin nëse diplomat e përfituara në institucionet/programet e arsimit të lartë jopublik në Shqipëri janë të akredituara ose jo;
- Faktin nëse diplomat e përfituara në institucionet e arsimit të lartë jashtë Shqipërisë janë të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ose jo;
- Faktin nëse kandidatët kanë përfituar më parë nga e njëjta skemë e punësimi;
- Faktin nëse aktualisht kandidati është nëpunës civil ose jo.

Përsa i përket procesit të vlerësimit me pikë të ekselentëve DAP sqaron se është bazuar në metodologjinë e vlerësimit të përmendur në pikën 2, të kreut II, të vendimit nr. 586, datë 30.08.2019, të ndryshuar dhe që gjendet bashkëlidhur këtij vendimi.

Kandidatët e kualifikuar vlerësohen me pikë në bazë të:

- a) mesatares së ponderuar - kandidatët përfitojnë pikët sipas tabelës së llogaritjes së mesatares, bashkëlidhur vendimit;
- b) nivelit të diplomës, vendit ku është kryer studimi dhe institucionit të arsimit të lartë – vlerësimi me pikë i kandidatëve për diplomën bëhet sipas pikës 4 të metodologjisë;
- c) angazhimeve në aktivitetet ekstrakurrikulare, vullnetarizmit dhe skemave të mobilitetit, ku përfshihen:
  - i. aktivitete ekstrakurrikulare konsiderohen angazhimet në projekte të ndryshme, pjesëmarrjet në konkurime apo olimpiada të ndryshme, pjesëmarrjet në grupe pune konferencash apo punime konferencash – 2 (dy) pikë;
  - ii. aktivitete vullnetarizmi konsiderohen angazhimet në ofrimin e shërbimeve për të përmirësuar jetën e komunitetit për të cilat nuk përfitohet shpërblim monetar – 3 (tre) pikë;
  - iii. pjesëmarrje në skema mobiliteti konsiderohen zhvillimi i një periudhe studimi (semestër/vit akademik) në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit ku kryhen studimet (psh ERASMUS, etj) – 5 (pesë) pikë.

Theksojmë se vlerësimi me pikë për angazhimin në aktivitete ekstrakurrikulare, vullnetarizëm dhe skema mobiliteti mbetet i njëjtë, pavarësisht numrit të aktiviteteve ku keni marrë pjesë.

Kjo do të thotë që nëse ju keni marrë pjesë në 2 projekte të ndryshme, pikët me të cilat do të vlerësoheni janë 2 pikë, ose nëse keni marrë pjesë në 2 skema mobiliteti, vlerësimi do të jetë me 3 pikë.

Gjithashtu, sjellim në vëmendje se në çdo rast, bazuar në shkronjën “d”, të pikës 4, të metodologjisë së vlerësimit të sipërpërmendur, sikurse është përmendur edhe në thirrjen për shprehje interesi, aktivitetet ekstrakurrikulare, aktivitetet e vullnetarizmit dhe skemat e mobilitetit duhet të pasqyrohen në jetëshkrim dhe të vertetohen me dokument zyrtar.

Konkretisht, në lidhje me vlerësimin në rastin tuaj, nga verifikimi i profilin tuaj elektronik rezulton se keni ngarkuar deri në datën 10.12.2024, dokumentacionin si më poshtë:

- Kartën e identitetit;
- Jetëshkrimin;
- Certifikatën e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetimin e aftësisë për punë;
- Libreza e Punës;
- Diploma e nivelit “Bachelor”;
- Diplomën e nivelit "Master Profesional";
- Diploma e nivelit “Master Shkencor”
- Vërtetimin me listën e notave të diplomës së nivelit “Master Profesional”, si dhe të nivelit “Master Shkencor”

Gjithashtu në rubrikën certifikatat, rezulton të keni ngarkuar:

- Certifikatë “Student i Shkëlqyer”;
- Certifikatë për zotërimin e gjuhës Italiane;

Sqarojmë se, zotërimi i gjuhës së huaj konsiderohet aftësi dhe jo angazhim në aktivitet ekstrakurrikular.

Bazuar në metodologjinë e vlerësimit të sipërpërmendur, si dhe në dokumentacionin e ngarkuar në profilin tuaj elektronik, jeni vlerësuar si më poshtë vijon:

a)për mesataren e ponderuar 9.81 - **16.20 pikë**

b) për diplomën “Master Profesional me 120 kredite në Mësuesi në Gjeografi për arsimin e mesëm në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë - **80 pikë**

**Totali: 96.2 pikë.**

Pas vlerësimit me pikë të kandidatëve të kualifikuar, DAP shpall në faqen e tij zyrtare, listën e ekselentëve të kualifikuar duke filluar nga ai me më shumë pikë. Lista përmban për secilin nga kandidatët:

- pikët e grumbulluara;
- grupet e pozicioneve në të cilat ata kanë të drejtë të përzgjedhin pozicionin e punës, sipas kriterit të nivelit dhe llojit të diplomës që kërkon pozicioni i punës, që nënkupton se pavarësisht renditjes në listë sipas pikëve, në çdo rast kandidati kualifikohet të përzgjedhë vetëm nga ato pozicione për të cilat ai plotëson nivelin dhe llojin e diplomës/arsimit të kërkuar.

Në këtë kuptim, mund të ndodhë që pavarësisht se një kandidat është renditur më lart me pikë në krahasim me një tjetër, të mos ketë mundësi të përzgjedhë pozicion pune për shkak të numrit të pozicioneve të disponueshme që kërkojnë diplomën që ai zotëron. P.sh. mund të ndodhë që një kandidat i cili zotëron diplomë në Shkenca Inxhinierike, të ketë pozicione të disponueshme për të përzgjedhur, pavarësisht se është vlerësuar me më pak pikë se një tjetër kandidat me Shkenca Juridike. Kjo për faktin se mund të ndodhë që: (i) numri i pozicioneve për të cilat kërkohen Shkenca Inxhinierike, të jetë më i madh në krahasim me numrin e pozicioneve për të cilat kërkohen Shkenca Juridike dhe (ii) numri i ekselentëve të kualifikuar që zotërojnë diplomë në Shkenca Inxhinierike, të jetë më i vogël në krahasim me numrin e pozicioneve për të cilat kërkohet kjo lloj diplome.

Pas publikimit të listës së kandidatëve të kualifikuar, DAP thërret kandidatët, të cilët, duke filluar nga ai me pikë më të larta brenda grupit përkatës, përzgjedhin pozicionin ku duan të emërohen në mënyrë të përkohshme. Kandidatët kanë të drejtën e përzgjedhjes vetëm midis pozicioneve për të cilat plotësojnë nivelin dhe llojin e diplomës që kërkon pozicioni i punës.

Në përfundim të verifikimit dhe shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve nga njësia përgjegjëse DAP, jeni njoftuar me email-in që keni bashkëlidhur ankesës suaj, se jeni kualifikuar me 96.2 pikë sipas metodologjisë së përcaktuar në VKM 586, datë 30.08.2019, i ndryshuar ku ju është dhënë linku i vendimit, <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil/405-vendim-nr-586-date-30-08-2019-per-punesimin-e-perkohshem-te-studenteve-te-ekselences-ne-institucionet-e-administrates-shteterore>, grupi i pozicioneve ku jeni kualifikuar, si dhe lista e kandidatëve të kualifikuar [https://www.dap.gov.al/images/Shpallja\\_Ekselente\\_te\\_Kualifikuar.pdf](https://www.dap.gov.al/images/Shpallja_Ekselente_te_Kualifikuar.pdf). Nga kjo listë mund të identifikohet niveli i arsimit që kandidatët e kualifikuar zotërojnë, universiteti dhe viti kur kanë përfunduar studimet, pikët që kanë grumbulluar secili, grupet e pozicioneve ku janë kualifikuar dhe kanë të drejtë të përzgjedhin sipas renditjes në pikë.

Nga lista e kandidatëve të kualifikuar, rezulton se jeni renditur e 70-ta me pikë dhe jeni kualifikuar për 9 pozicionet e mëposhtme, bazuar në nivelin dhe llojin e diplomës që kërkohet për këto pozicione:

3 - Administrata e Prefektit të Qarkut Berat, Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, në Administratën e Prefektit të Qarkut Berat, Klasa e pagës: IV-3;

4 - Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, Specialist në Sektorin e Administrimit të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Kukës, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, Klasa e pagës: IV-3;

147 - Agjencia Kombëtare e Falimentimit (AKF), Specialist në Agjencinë Kombëtare të Falimentimit, Klasa e pagës: IV-3;

148 - Agjencia Rajonale e Bregdetit Sarandë (ARB Sarandë), Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Rajonale të Bregdetit Sarandë, Klasa e pagës: IV-2

149 - Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit, Specialist (Arkivist/ Protokollist) në Sektorin Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit, Klasa e pagës: IV-3;

150 - Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Specialist në Sektorin e Certifikimit të Bazës së të Dhënave, në Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH/ Dega e Certifikimit të Bazës së të Dhënave dhe Periudhave Individuale të Sigurimit, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore;

151 - Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE (AAPAA), Specialist (Marrëdhënie me Jashtë) në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë e Financës dhe Juridike, në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE, Klasa e pagës: IV-2;

152 - Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Specialist në Sektorin e Bashkëpunimit Territorial, në Drejtorinë e Konvergjencës dhe Kohezionit me BE-në, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Klasa e pagës: IV-1;

153 - Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Specialist në Sektorin e Trashëgimisë Materiale dhe Jomateriale, në Drejtorinë e Politikave për Trashëgiminë Kulturore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Klasa e pagës: IV-1;

Në vijim të procedurës së ndjekur, jeni njoftuar me email për t'u paraqitur në datën 15.01.2025, në orën 14:15, për të përzgjedhur nga grupi i pozicioneve ku jeni kualifikuar, referuar renditjes me pikë.

Në momentin tuaj të përzgjedhjes, situata në lidhje me pozicionet për të cilat ishit kualifikuar, paraqitej si më poshtë:

pozicioni me nr. 3 - i pa përzgjedhur në momentin tuaj të përzgjedhjes

pozicioni me nr. 4 - i pa përzgjedhur në momentin tuaj të përzgjedhjes

pozicioni me nr. 147 - përzgjedhur nga kandidati S. S. me 102 pikë

pozicioni me nr. 148 - përzgjedhur nga kandidati K. L. me 102 pikë

pozicioni me nr. 149 - përzgjedhur nga kandidati F. M. me 100 pikë

pozicioni me nr. 150 - përzgjedhur nga kandidati F. S. me 102 pikë

pozicioni me nr. 151 - përzgjedhur nga kandidati E. S. me 107 pikë

pozicioni me nr. 152 - përzgjedhur nga kandidati L. Z. me 160 pikë  
pozicioni me nr. 153 - përzgjedhur nga kandidati F. H. me 152.4 pikë

Duke qenë se dy pozicionet e disponueshme në momentin tuaj të përzgjedhjes, ndodheshin jashtë Tiranës, ju vendosët të mos zgjidhni asnjërin prej tyre.

Në zbatim të pikës 11, të kreut II, të vendimit nr. 586, datë 30/08/2019, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së pozicioneve të punës nga ana e kandidatëve të kualifikuar, në datën 24.01.2025 publikoi listën e kandidatëve që përzgjedhën vendet e punës dhe do të punësohen me kontratë të përkohshme 1 vjeçare në institucionet e administratës shtetërore. Bashkëlidhur linku i rezultateve të përzgjedhjes [https://www.dap.gov.al/images/2025\\_01\\_Rezultatet\\_per\\_publicim\\_Ekselencia.pdf](https://www.dap.gov.al/images/2025_01_Rezultatet_per_publicim_Ekselencia.pdf).

Në përfundim, bazuar në sqarimet e mësipërme dhe në informacionin e dhënë nga Departamenti i Administratës Publike ditën e paraqitjes suaj në DAP, si dhe në email-in e datës 20.01.2025 është e qartë se procedura e përzgjedhjes dhe renditjes së kandidatëve është realizuar në përputhje me metodologjinë dhe kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 586, datë 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar,

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,